



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA E TIRANËS

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE E GJELBËRIMIT

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nr. Prot

Tiranë më, 03.06.2022

Drejtuar: **Adenis Kastrati Kastrati P.F** me Nipt **L51611004I** Adresa: Tirane-Kamez-Bathore, Lagja Nr. 4, Rruga "Demokracia", Godina nr. 29, Kati 1 me administrator Adenis Kastrati

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: **REF-28962-05-13-2022**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "**Blerje pajisje kompjuterike dhe aparate**" me fond limit: **1 620 000** (njemilion e gjashtëqind e njezet mije) lekë (pa TVSH). Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **30 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Publikimet e mëparshme: Nuk Ka pasur

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 67 datë 23 Maj 2022

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertues si më poshtë vijon me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Adenis Kastrati Kastrati P.F

L51611004I

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Me ofertë ekonomike: **1,378,000** (njemilion e treqind e shtatëdhjetë e tete mijë) lekë pa TVSH.

2. BNT ELECTRONICS shpk

J61817047D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Me ofertë ekonomike: **1,580,940** (njemilion e pesëqind e tetëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzetë) lekë pa TVSH.

3. Ervin Luzi

Emri i plotë i shoqërisë

K71707007Q

numri i NIPT-it

Me oferte ekonomike: **1,489,000**(një milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë)
lekë pa TVSH

4. “EURO INFORM ” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

K33721008C

numri i NIPT-it

Me ofertën ekonomike: **1,430,300**(një milion e katërqind e tridhjetë mijë e treqind)
lekë pa TVSH.

5. “KALLFA” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

J71406006Q

numri i NIPT-it

Me oferte ekonomike: **1,257,000**(një milion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë)
lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit është skualifikuar Ofertuesi i mëposhtëm:

1. “KALLFA” shpk

Emri i plotë i shoqërisë

J71406006Q

numri i NIPT-it

Me oferte ekonomike: **1,257,000**(një milion e dyqind e pesëdhjetë e shtatë mijë)
lekë pa TVSH.

Klasifikimi u bë për arsyet e mëposhtme:

- I plotëson kërkesat e përgjithshme për kualifikim
- Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST
- Përsa i përket llogaritjes së vlerës së ofertës nuk rezulton anomalisht e ulët.

KALLFA sh.p.k nuk përmbush kriteret e specifikimeve teknike përse i përket Kompjuter Desktop 2.

Ku specifikisht, përkthimi i paraqitur nga përkthyesja e miratuar nuk përkon me specifikimet teknike të file-t në gjuhën angleze të paraqitura për DESKTOP

ACER VERITON ES2740G. Përkthimi është copy-paste i specifikimeve teknike për llojin e PC DESKTOP 2 të kërkuara nga AK referuar websitet të AKSHI.

Sqarojmë se për kompjuter DESKTOP 2, nuk janë specifikuar të dhënat si lloji i kartës grafike GPU (Graphic Processing Unit), (DVI, HDMI, VGA), dhe qartësisht siç është kërkuar në specifikime nuk është as cilësuar madhësia e kartës grafike në RAM (pra cila është madhësia në RAM dhe lloji i kartës grafike, pasi sigurisht që kompjuteri desktop i assembluar të cilin OE e ofron duhet ti ketë të dhënat dhe parametrat qartësisht të renditura, apo minimalisht të nënvizuara në file-n e uploaduar nga OE). Sqarojmë se kompjuterat DESKTOP duhet të përmbajnë llojin e kartës grafike GPU, pra nëse është e familjes Intel Graphics, familjes Nvidia, familjes AMD, familjes ASUS, familjes ZOTAC apo ndonjë markë tjetër prodhimi pre-installed e GPU, komponent i çdo DESKTOP në shitje (sqarojmë se nuk cilësohet në dokumentin në gjuhë angleze dhe çfarë shkruhet shqip si përkthim në faqen e pare nuk përkon me dokumentin në anglisht).

Gjithashtu OE KALLFA sh.p.k nuk ka cilësuar as procesorin e instaluar në ACER VERITON ES2740G. Pra cila është familja e procesorit të instaluar në këtë desktop (njësi qendrore)?

Nëse kemi të bëjmë me një familje procesorësh të gjeneratës së 10 Intel Core, ndërkohë duhet të specifikohet qartë se cili procesor është i instaluar tek desktop ACER VERITON ES2740G. Ka diferencë domethënëse jo vetën në performancë por edhe në çmim midis familjeve të procesorëve Intel Core i7, Intel Core i5, Intel Core i3, Intel Pentium, Intel Celeron. Nuk është e qartë se cilin prej këtyre procesorëve përmban kompjuteri DESKTOP ACER VERITON ES2740G, diferencë e cila përkthehet qartazi edhe në ofertën ekonomike, pasi lloji i procesorit është nga komponentët kryesor të DESKTOP PC.

Në këtë kuadër nuk janë cilësuar as kapaciteti i memories RAM (pra cila është memoria RAM e instaluar tek DESKTOP ACER VERITON ES270G), 32 GB RAM, 16 GB RAM apo 8 GB RAM? Gjithashtu nuk është cilësuar as kapaciteti i nxënies së Hard Disk drive (pra cili është kapaciteti i hard disk (2 TB, 1 TB apo 500 GB?).

Më tej, specifikimet teknike nuk përmbajnë informacion mbi llojin e Monitorit (ekranit). File i uploaduar nuk e përmban këtë lloj informacioni dhe gjithashtu për sa relevant informacioni i fotove përmban vetëm figurën e 'trurit' apo njësisë qendrore dhe jo të monitorit. Vërtetimi i përkthimit në këtë rast nuk është i qartë

se cilit element i drejtohet, pasi dokumentacioni në gjuhë angleze nuk e përmban atë.

Sqarojmë për sa më sipër se kjo bie në kundërshtim me pikën 2.3.3 të ‘Kapacitetit Teknik’ ku citohet se: “Operatori ekonomik duhet që në ofertën teknike të paraqesë markën, modelin dhe katalogë/brosurë për mallin që oferton. Në katalog, të markohet në menyrë të qartë dhe të dallueshme secili nga artikujt e kuotuar sipas modelit të deklaruar dhe të markohen edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DST. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli që është objekt i prokurimit me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Specifikimet teknike të markës dhe modelit të kuotuar do të krahasohen me katalogun e paisjeve dhe specifikimet teknike të DST për përputhshmerine e tyre”.

Në broshurën e paraqitur nuk janë paraqitur të nënvizuara ‘highlighted’ apo të markuara karakteristikat e DESKTOP ACER VERITON ES2740G nga OE Kallfa sh.p.k.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **operatori ekonomik Adenis Kastrati Kastrati P.F meNIPT: L51611004I**me Adresë: Adresa: Tirane-Kamez-Bathore, Lagja Nr. 4, Rruga “Demokracia”, Godina nr. 29, Kati I me administrator Adenis Kastrati, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **1,378,000** (një milion e treqind e shtatëdhjetë e tete mijë) **lekë pa TVSH** dhe vlera totale:

1,653,600 (një milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e tremijë e gjashtëqind) **lekë me TVSH** është identifikuar si Oferta më e suksesshme e bazuar në çmim.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **01.06.2022** në sistemin elektronik të APP-së.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Arlinda Binjaku